



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.32/2018
Prishtinë, më 21.6.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Liburn Aliu, Hykmete Bajrami, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj dhe Bilall Sherifi, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Mimoza Kusari – Lila, Glauk Konjufca dhe Duda Balje, anëtarë.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.6.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-038 për Shërbimet Postare;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;
5. Shqyrtimi i Pakos Legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së Infrastrukturës, më qëllim të harmonizimit me Ligjin për Kundërvajtje;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.6.2018;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 18.6.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-038 për Shërbimet Postare;

Sala Berisha-Shala, kryetare, theksoi se në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, komisionet e përhershme nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje për Raportin me amendamente të Projektligjit nr.06/L-038 për Shërbimet Postare, përveçse Komisioni për integritet Evropian, cili nuk e ka shqyrtuar Raportin me amendamente brenda afatit kohor, siç parashihet me Rregullore të Kuvendit. Në bazë të Rregullores së Kuvendit mund të procedojmë tutje, andaj, kërkoj që të votohet raporti me rekomandime, në mënyrë që të shkojë në lexim të dytë.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr.06/L-038 për Shërbimet Postare;*
- 2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;

Sala Berisha-Shala, kryetare, theksoi se në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, komisionet e përhershme nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje as Raportin me amendamente të Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe, përveçse Komisioni për integritet Evropian, nuk e ka shqyrtuar Raportin me amendamente brenda afatit kohor siç parashihet me Rregullore të Kuvendit. Në bazë të Rregullores së Kuvendit mund të procedojmë tutje, andaj, kërkoj që të votohet raporti me rekomandime, në mënyrë që të shkojë në lexim të dytë.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;*
- 2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

5. Shqyrtimi i Pakos Legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së Infrastrukturës, më qëllim të harmonizimit me Ligjin për Kundërvajtje;

Kryetarja ia kaloi fjalën deputetes Hykmete Bajrami, si kryesuese e grupit punues për shqyrtimin e Pakos Legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së Infrastrukturës, që të paraqes Raportin me amendamente.

Hykmete Bajrami, theksoi se grupi punues ka shqyrtuar këtë pako legjislative, duke theksuar se këto janë ndryshime kryesisht teknike që kanë të bëjnë me harmonizimin e pjesës së dënimeve me Ligjin për Kundërvajtje. Kemi dy amendamente të deputetit Korab Sejdiu, në ndryshim plotësimin e Ligjit për Patentë shoferi, por amendamenti 1, është edhe i Komisionit dhe besoj që deputeti do të tërhiqet, pra nuk duhet ta përkrah Komisioni, si dhe amendamenti 2, është bërë në Ligjin bazik e jo në projektligj, dhe sipas këshillës së stafit të Komisionit, ky propozim është në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, prandaj, duhet të jetë pa përkrahje edhe pse arsytimi i dhënë nga ana e deputetit qëndron, por, nëse Komisioni për Legjislacion i jep mbështetje atëherë edhe Komisioni jonë duhet ta mbështes.

Kryetarja, propozoi që të votohen këto ndryshime që janë bërë nga grupi punues, kurse amendamentet e deputetit Sejdiu, të mos përkrahen në këtë fazë, pasi që janë në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, ndërsa, nëse Komisioni për Legjislacion i jep përkrahje atëherë edhe Komisioni ynë do ta mbështet. Ajo propozoi që nëse nuk ka ndonjë vërejtje rreth amendamenteve, të votohen në bllok të gjashtë projektligjet.

Propozimi i kryetares u përkrah nga Komisioni.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohen Raportet me amendamente të Pakos së projektligjeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së Infrastrukturës;*
- 2. Raportet me amendamente të Pakos së projektligjeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së Infrastrukturës, procedohen në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës.*

Raportet me amendamente i bashkëngjiten këtij procesverballi.

6. Te ndryshme. **Çështjet vijuese**

Kryetarja, njoftoi deputetët për vizitën zyrtare që e realizoi një delegacion i Komisionit në Berlin të Gjermanisë, më 7- 9 qershor 2018, për çka edhe u është shpërnda njoftimi me shkrim në lidhje me vizitën e realizuar.

Njoftimi rreth vizitës së Komisionit në Berlin/Gjermani më 7- 9 qershor 2018, ti procedohet Kuvendit.

Kryetarja, njoftoi deputetët se Sindikata e Punëtorëve të Trepçës ka dërguar një komunikatë, se nëse kërkesat e sindikatës në lidhje me statutin nuk merren parasysh, ata do të hyjnë në grevë.

Prandaj, ajo e autorizoi koordinatorin e Komisionit që Sindikatës së Punëtorëve të Trepçës t'i kthehet një përgjigje se Komisioni është në proces të shqyrtimit të Projektstatutit të Trepçës dhe ka ndërmarrë hapa për sqarimin e shqetësimeve të sindikatës, dhe nga sindikata të kërkohej ti procedohet Komisionit Lista e aseteve të Trepçës, ashtu siç i është kërkuar Bordit studimi i fizibilitetit.

Pas debatit, Komisioni u dakordua që të zhvillohet një takim me ministrin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në ambientet e kësaj ministrie, në mënyrë që të merret opinioni i tij në lidhje me studimin e fizibilitetit që potencohet në Projektstatut..

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi;

Datë: 21.6.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 21.6.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoit Projektligjin nr.06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit riformulohet si në vijim;

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-064 për patentë shoferi.

Amendamenti 2 – dy propozime:

A. Propozimi i Komisionit

Neni 1, riformulohet si në vijim:

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 05/L-064 për patentë shoferi.

B. Propozim i deputeteit Korab Sejdiu, pa perkrahje të Komisionit

Neni 1 plotësohet duke shtuar fjalët “*plotësimi dhe*” në rreshtin e parë pas fjalës “është” dhe para fjalës “harmonizimi:”

Amendamenti 3

Neni 2, pas shumës “(200)’ dhe “(600)’ shtohet shprehja “euro”. Dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti 4

Neni 4, pas fjalës “Ligji bazik” i shtohet referenca “paragrafi 5”.

Amendamenti 5

Neni 5, riformulohet si në vijim:

“Neni 48 i Ligjit bazik, paragrafët 5., 6., dhe 7. ndryshohen si në vijim:”

Amendamenti 6

Neni 9, referenca “paragrafin 3” zëvendësohet me “paragrafin 4”.

Amendamenti 7, i deputetit Korab Sejdiu, pa perkrahje të Komisionit

Në mes të Nenit 9 dhe Nenit 10 të projektligjit shtohet një nen me përmbajtjen si në vijim:

Në fund të paragrafit 1 të Nenit 97 shtohet fjalia

“Me rastin e aplikimit për ndërrim në patentë shoferi, Ministria nuk ia merr personit patentë shoferin nga vendi i origjinës dhe ia këthen personit atë pas kryerjes së procedurave për ndërrim të patentë shoferit”.

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integrime Evropiane;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor;

Datë: 21.6.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 21.6.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoi Projektligjin nr.06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Tituli i projektligjit riformulohet si në vijim;

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor.

Amendamenti 2

Neni 1, riformulohet si në vijim:

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor.

Amendamenti 3

Neni 2, pas shumë “(300)” dhe “(150)” shtohet shprehja “euro”. Dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti 4

Neni 7, riformulohet si në vijim:

“Neni 55 i Ligjit bazik, paragrafët 2, dhe 3. ndryshohen si në vijim:”

Amendamenti 5

Neni 20, riformulohet si në vijim:

“Neni 233 i Ligjit bazik, paragrafët 3.,4.,5.,6. dhe 7. ndryshohen si në vijim:”

Amendamenti 6

Neni 23, riformulohet si në vijim:

“Neni 249 i Ligjit bazik, paragrafët 2. dhe 3. ndryshohen si në vijim:”.

Amendamenti 7

Neni 25, riformulohet si në vijim:

“Neni 255 i Ligjit bazik, paragrafët 6. dhe 7. ndryshohen si në vijim:”.

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integrime Evropiane;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120;

Datë: 21.6.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 21.6.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoit Projektligjin nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit riformulohet si në vijim;

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/11 për Rrugë i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.03/L-120.

Amendamenti 2

Neni 1, riformulohet si në vijim:

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.2003/11 për Rrugë i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.03/L-120.

Amendamenti 3

Neni 2, shprehja “për plotësimin dhe ndryshimin ose plotësohet ndryshohet” zëvendësohet me shprehjen “për ndryshimin dhe plotësimin ose ndryshohet dhe plotësohet” si dhe pas shumës së gjobave shtohet shprehja “euro”. Këto ndryshime vlejn për tërë tekstin e projektligjit

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës;

Datë: 21.6.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 21.6.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoi Projektligjin nr.06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit riformulohet si në vijim;

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

Amendamenti 2

Neni 1, riformulohet si në vijim:

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

Amendamenti 3

Neni 2, riformulohet si në vijim:

“Neni 143 i Ligjit bazik, paragrafët 2.; dhe 4. ndryshohen si në vijim:”

Amendamenti 4

Neni 2, nënparagrafi 1.1., pas shumës “2000’ shtohet shprehja “euro”. .

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor;

Datë: 21.6.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 21.6.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoit Projektligjin nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit riformulohet si në vijim;

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-179 për transportin rrugor.

Amendamenti 2

Neni 1, riformulohet si në vijim:

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.04/L-179 për transportin rrugor.

Amendamenti 3

Neni 2, riformulohet si në vijim:

“Neni 74 i Ligjit bazik, paragrafët 1.; 3.; dhe 5. ndryshohen si në vijim:”

Amendamenti 4

Neni 3, riformulohet si në vijim:

“Neni 76 i Ligjit bazik, paragrafët 1.; nënparagrafi 2.2.; 3.2; 4.2.; 5.2; 6.2; 7.2; 8.2; 9.2; 10.2; 11.2.; 12.2; paragrafet 12.; 13.; 14.; 15.; 16.; 17.; dhe 18. ndryshohen si në vijim:”

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme;

Datë: 21.6.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 21.6.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoit Projektligjin nr.06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit riformulohet si në vijim;

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme.

Amendamenti 2

Neni 1, riformulohet si në vijim:

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme.

Amendamenti 3

Neni 2, riformulohet si në vijim:

“Neni 58 i Ligjit bazik, paragrafi 1. ndryshohet si në vijim:

1. Personi juridik për kundërvajtje gjobitet pesëqind (500) deri në një mijë (1.000) euro, nëse:”

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA SHALA

